



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 670/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.10.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së BOE “B 93” sh.p.k & “Arkonstudio” sh.p.k & “Rafin Company” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr.REF-23687-05-24-2019, me objekt: “*Ndërtim i rrjetit të jashtëm të Ujësjellësit Këlcyrë*”, me fond limit 151.169.770 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 26.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Këlcyrë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e shoqërisë “Be-Is” sh.p.k.

Ankimues: BOE “B 93” sh.p.k & “Arkonstudio” sh.p.k & “Rafin Company” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k
Lagja “8 Shkurti”, Rr. “Andon Doro”, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Këlcyrë.
Sheshi “Musa Fratari”, Këlcyrë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.

914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr.23687-05-24-2019, me objekt: “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të Ujësjellësit Këlcyrë”, me fond limit 151.169.770 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 26.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Këlcyrë.

II.2. Në datën 22.07.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|--------------------|--------------------------------|
| 1. “B 93” sh.p.k | 123.292.128 lekë, skualifikuar |
| 2. “Senka” sh.p.k | 135.070.212 lekë, skualifikuar |
| 3. “Be-Is” sh.p.k. | 150.720.070 lekë, kualifikuar |

Operatori ekonomik ankimues rezulton i skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me argumentat si më poshtë vijon:

1. Të skualifikojë BO “B 93” shpk “Arkon Studio “shpk “Rafin Company” shpk Shendelli”shpk për shkak se Operatori nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të sakte për të deshmuar plotësimin e pikës 1.a të kriterëve të vecanat për kualifikim. Kjo sepse Operatori nuk e ka plotësuar formularin e ofertes sipas formatit standart të shtojca 1 e DST por e ka ndryshuar atë.

Shtojca 1 e DST është formular standart dhe duhet plotësuar në rubrikat e saj sic është percaktuar në të. Pra duhet deklaruar vlera e ofertes pa tvsh dhe vlera e ofertes me tvsh si dhe tabela perkatëse. Në DST, Udhëzime për operatorët, seksioni 2. Perlllogaritje e ofertes ekonomike, pika 2.1 shprehimisht percaktohet ...

Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, nderkohe që, operatori ka paraqitur një shtojcë të ndryshuar, duke deklaruar këto vlera të ndryshme oferte, e madje duke e ndare oferten në elemente të ndryshme.

Deklarimi i bere nga operatori në shtojcën 1 të krijojnë perceptimin sikur kemi të bëjmë me dy lote të ndryshme brenda së njëjtes procedure (njëri lot për punime ndërtimi dhe një lot për makineri pajisje) nderkohe që në fakt, procedura objekt prokurimi është në një lot, ka një preventiv (pavaresisht kapitujve e ndarjeve që ka preventivi) dhe për rrjedhojë duhet të kishte paraqitur një oferte me dy deklarime sipas shtojcës 1 të DST, ku duhet të kishte vetëm një deklaram për vlerën e ofertes pa tvsh dhe një deklaram me vlerën me tvsh. Në rregullat e prokurimit, DST, Kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomike”, Seksioni 1 Hartimi i ofertës, në pikën 1.1 thuhet shprehimisht;

Citoj... 1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e percaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

2. Operatori ka paraqitur vlerën e ofertes pa tvsh, duke e perlllogaritur në kundërshtim me percaktimet e ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrisë të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” si dhe Udhëzimit nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, (formulari i ofertes i paraqitur nga operatori ka gabime në perlllogaritjen e vlerës pa tvsh).

Konkretisht;

Sipas formularit të ofertes, shtojca 1 e DST, operatori ka deklaruar cmimin e ofertes në vlerën 123 292 128 leke pa tvsh dhe cmimi i ofertes me tvsh në vlerën 147 950 554 leke.

Gjithashtu në këtë formular është deklaruar cmimi 16 387 243 leke me tvsh për makineri e pajisje dhe cmimi total i ofertes në vlerën 164 337 797 leke me tvsh por, operatori ka perlllogaritur gabim vlerën e ofertes pa tvsh, duke mosperfishire në të vlerën e pajisjeve të cilat sipas Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrisë të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, duhet të perfishiheshin në vlerën e ofertes pa tvsh. Kjo sepse;

Ne respekt të udhëzimit të sipërcituar, autoriteti kontraktor, në cilësinë e tatimpaguesit investitor ka parashikuar në preventiv se për zërin Makineri Pajisje nuk tatóhet dy herë në total me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Përsa kohë që paisjet e mësipërme, të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën që duhet të paraqesnin operatorët, vlera totale e paisjeve duhet të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH.

Sa më sipër, gjykojmë se, në përllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH në rastin e këtij objekti prokurimi, ku krahas punimeve të ndertimit ka edhe pajisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të duhej të ishte vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohen së bashku me TVSH), kjo duke u bazuar edhe në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Në këto kushte, gjykojmë se, vlera e ofertes ekonomike 123 292 128 leke pa TVSH e paraqitur nga BO, e cila është përllogaritur pa përfshire vlerën e pajisjeve, është në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të sipërcituara. Nqs vlera e ofertes do të përllogaritej konform bazës ligjore në fuqi, atëherë vlera e ofertes se këtij BO do të ishte 139 679 371 leke pa tvsh. Pra shihet qarte se ka një gabim në përllogaritjen e deklarimit të ofertes pa tvsh në Shumen 16 387 243 leke ose 11.7 % të vlerës së ofertes pa tvsh. Nga ana tjetër, gjykojmë se përllogaritja dhe deklarimi i vlerës ekonomike pa tvsh, duke mospërfshire në të vlerën e pajisjeve, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik ofertues në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të kësaj procedure. Në këtë rast KVO vepron konform përcaktimeve të Vendimit KPP 600/2018 në të cilën është shprehur qarte se, mospërfshirja e vlerës së pajisjeve në vlerën e ofertes pa tvsh, është ndryshim i vlerës së ofertes pa tvsh dhe përben shkak të ligjshëm për skualifikim .

3. Të skualifikojë B O për shkak se operatori ekonomik ka përllogaritur paga orare për një pjesë të zerave të preventivave e cila është nën minimumin ligjor të lejuar.

Kështu , në analizat e cmimeve të paraqitura , rezulton se paga orare për një pjesë të zerave të punës që parashikon preventivi i procedurës objekt prokurimi dhe konkretisht zërat nr.analiz 3.46/1 ; 3.47/1c , 3.377 , 2.37/5b , 2.1b, 3.47/1b , 2.258, 164/1a, 2.426/4, 2.426/3 , An9, heqja e shtresë izoluese egzistuese , 2.258/2, An cmontim heqje dyer dritare , An heqje shtresë dyshemeje, An heqje shtresë suvatimi në mure të brendshme , An heqje shtresë suvatimi në mure të jashtme , An heqje shtresë suvatimi në tavane , etj janë përllogaritur me 125 lekë/op.

Në nenin 11 të K Punes përcaktohet; ...Paga minimale ...Paga nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në V.K.M nr. 809 datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, përcaktohet shprehimisht: “Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 26.000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 149 (njëqind e dyzetë e nëntë) lekë.

Pra, duke qenë se paga orare minimale duhet të jetë 149 lekë, llogaritjet e bëra në analizat e paraqitura për pagën orare në masën 125 lekë , bien në kundërshtim me vendimin e mësipërm.

Skualifikimi per kete arsye te perlllogaritjes se gabuar te pages orare mbeshitet ne vendimet e KPP, si psh KPP 313/2014; KPP 819/2016 etj.

Skualifikimi per kete arsye eshte konsideruar i ligjshem edhe nga APP ne rastin e propozimeve te KLSH-se per auditimin e kryer ne Bashkine Kelcyre.

Ne rregullat e prokurimit dhe Praktiken e vendimarrjeve te KPP theksohet se mosplotesimi qofte edhe nje kriteri te vetem perben shkak per skualifikim e operatorit.

4.Operatori nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te sakte per te deshmuar plotesimin pikes 1 te kriterëve te pergjithshme per kualifikim (per rastin kur oferta paraqitet si bashkim operatorësh) si dhe percaktimeve te nenit 74 te VKM 914 date 29.12.2014 ku shprehimisht thuhet: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Operatori ka paraqitur kontraten noteriale te bashkepunimit te dates 25.06.2019 me nr 3153 rep dhe nr 1395 kol si dhe prokuren e posacme po e dates 25.06.2019. Sipas nenit 3 te kesaj marreveshje bashkepunimi, ku eshte dakortuesuar % e ndarjes se punimeve, palet kane percaktuar se elementet konkrete te punimeve qe do të kryeje sejcili prej pjesetareve te ketij bashkimi eshtë e percaktuar ne aneksin 1 bashkelidhur kontrates .

Nga shqyrtimi i aneksit nr.1 konstatohet lehtesisht se aneksi nr.1 nuk ka nenshkrimin dhe vulen e perfaqesuesve anetare te ketij bashkimi operatorësh. Mungesa e nenshkrimeve dhe vules se sejcilit prej anetareve de jure dhe de facto deshmon se ky Bashkim operatorësh nuk arrin te paraqese dokumentacion te plote dhe te rregullt per elementet konkret qe do kryeje sejcili pjesetar i BO.Sipas percaktimeve te nenit 74 pika 2 i VKM nr.914”Rregullat e Prokurimit Publik”I ndryshuar preventivi i ndarjes se punimeve (percaktimi i elementeve konkrete qe do te kryeje secili pjestar i BO) duhet të firmoset dhe vuloset nga secili prej anetareve te BO.

Fakti i mesiperm perben arsye ligjore per ta kondideruar te parregullt marreveshjen e bashkepunimit midis operateve ekonomike kjo referuar kreut 8 nenit 74 pika 2 e VKM. nr.914”Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Por gjithashtu edhe kontrata e bashkepunimit dhe prokura e posacme ne faqen e fundit te aktit noterial nuk kane vendosur me shkrimin e tyre

emrin dhe mbiemrin e tyre por thjesht e vetem nënshkrimin. Kjo është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 102 pika 1 të ligjit 110/2018 “ Per noterine”, ku shprehimisht përcaktohet: aktet noteriale nënshkruhen rregullisht nga pjesëmarrësit në aktin noterial, në prani të noterit, pasi noteri ka hartuar aktin dhe ua ka bërë të ditur përmbajtjen e tij palëve. Nënshkrimi shoqërohet me emrin dhe mbiemrin e plotë të palëve. Palët vendosin nënshkrimin e tyre në çdo faqe të aktit noterial dhe në fund të aktit noterial vendosin emrin, mbiemrin, si dhe nënshkrimin e tyre.

5. Një nga pjesëtarët e këtij BO, konkretisht operatori B 93 shpk ka paraqitur dokumentacion të pasakte për të deshmuar plotësimin e pikës 2.3.1 të kriterëve të vecanta për kualifikim. Në këtë pikë është kërkuar:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

c) Punë të ngjashme e realizuar në një kontratë të vetme me vlerë sa 50% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit (përllëgëruar nga data e zhvillimit të tenderit) ose d) punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit (përllëgëruar nga data e zhvillimit të tenderit) është në një vlerë sa dyfishi i vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën oferten të kualifikueshme.

Pra, sipa specifikimeve të mesipërme, përllëgëruarja e afatit tre vjeçar do të bëhet referuar datës së hapjes së ofertave. Sipas aktit marrëveshës se bashkëpunimit, operatori B 93 shpk ka marrë persiper të kryejë 54.03 % të punimeve. Në zbatim të përcaktimeve të nenit 74 të VKM 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, si pjesë e BO, duhet që kriterin për punë të ngjashme si një kriter që bën pjesë tek kapacitetet teknike duhet ta plotësojë në përputhje me % e marrë persiper në aktin marrëveshës.

Për të deshmuar plotësimin e këtij kriteri operatori B 93 shpk ka paraqitur edhe kontratën “Nëntim ujesjellesi të fshatit Corrush Anberg “ kontratë bazë +shtesë kontratë .

Kontrata bazë është realizuar në vlerën 75 925 925 leke pa tvsh dhe shtesë kontratë në vlerën 14 262 398 leke pa tvsh. Krahas kontratave, operatori ka paraqitur edhe dokumentacionin bashkëlidhur si formular vlerësimi e faturat tatimore. Nga ky dokumentacion rezulton se, punimet e kontratës bazë janë realizuar jashtë afatit ligjor tre vjeçar të vlefshme për të deshmuar realizimin e kontratave të ngjashme. Kjo sepse, sic deshmohet në formularin e vlerësimit, kontratë bazë ka përfunduar me datën 11.04.2016 nënkohë që dt e hapjes së ofertave është datë 26.06.2019.

Po kështu edhe nga faturat tatimore të kontratës bazë të paraqitura rezultojnë se janë jashtë afatit tre vjeçar të përcaktuar në rregullat e prokurimit. Nga shqyrtimi i faturave të paraqitura rezulton se fatura me e fundit me afër dt. hapjes së ofertave është datë 01.05.2016 .

Sa më sipër, KVO gjykon se, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit, kontratë bazë ujesjellesit paraqitur nga B 93 shpk konsiderohet jashtë afatit 3 vjeçar të parashikuar nga neni 26 pika 6 e VKM 914/2014, duke mos përmbushur kriterin e kualifikimit në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë.

Në përllëgëruarjen e këtij afati trevjeçar, KVO i referohet praktikës së vendimarrjeve të KPP sic është rasti i K.P.P. 521/2016, K.P.P. 874/2016 etj.

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur gjithashtu edhe kontratat me objekt “Rikonstruksioni i Rrugës Pishëporo Bregdet, Njësia Administrative Levan”,

nënshkruar me AK Bashkia Fier datë 10.11.2017, kontratën me objekt “Rruga Dejë Qendër”, nënshkruar me AK Bashkia Vau Dejës datë 13.05.2017. Referuar kontratave të paraqitura të sipërcituara nga B93 shpk nuk janë te natyrës së ngjashme me kontratën objekt prokurimi. Nga shqyrtimi i kontratave të paraqitura rezulton se janë për ndërtim apo rikonstrukcion rruge ndërsa ndërsa kontrata objekt prokurimi është ndërtim rrjet ujeshjellesi.

Në këto kushte operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë se disponon kapacitetet teknike, përvojën e duhur në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar kontratën objekt prokurimi për arsye se vlera e kontratës së vetme të vlefshme (shpesh kontrate “Ndërtim ujeshjellesi të fshatit Corrush Anberg”) nuk arrin vlerën e kërkuar as në gjurmën a) të pikës 2.3.1 a dhe pikën 2.3.1 b) të DST.

6. Njëri nga pjesëtarët e këtij BO, konkretisht operatori B 93 shpk nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të sakte për të dëshmuar plotësimin e pikës 2.3.4.d të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe konkretisht (nuk ka paraqitur dëshmi kualifikimi profesional për profesionet elektromekanike, mekanike dhe hidraulike). Sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit operatori B 93 shpk ka marrë përsipër të kryejë 54.03% të punëve ndërsa në aneksin e ndarjes punëve ka marrë përsipër të kryejë punime hidraulike ,elektrike ,mekanike .

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik B 93 sh.p.k ka paraqitur kontratë punë me palë z.V.Calaj datë 24.06.2019 punësuar si elektromekanik shoqëruar me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur komisioni i vlerësimit të ofertave evidenton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit. Gjithashtu në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST përse i përket profesionit hidraulik operatori ekonomik ka paraqitur kontratë punë datë 07.05.2019 me palë z.A.Licaj shoqëruar me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur komisioni i vlerësimit të ofertave evidenton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar natyrës së punimeve të marra përsipër nga operatori ekonomik B 93 sh.p.k konstaton se në përmbushje të kriterit 2.3.4 pika d dhe përkatësisht profesionit saldator ka paraqitur kontratë punë nënshkruar me z.P.Caushaj datë 01.05.2017 shoqëruar me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, si dhe çertifikatë trajnimi lëshuar nga AQSCERT.

Kështu nga verifikimet e kryera nga K.V.O në adresën qkb.gov.al për AQSCERT rezulton se në objektin e veprimtarisë së tij nuk ka e nuk është njohur nga ndonjë institucion shtetëror në rastin konkret nga ministria përkatëse e punës e drejta e tij për të organizuar kurse formimi profesional. Theksojmë se e drejta e organizimit të kurseve profesionale jepet me autorizim nga ish ministria e punës dhe mireqenies sociale.

Gjate shqyrtimit të ekstraktit historik të organizimit AQSCERT në adresën qkb.gov.al në objektin e veprimtarisë janë vlerësimit i konformitetit të implementimit të standarteve ndërkombëtare ISO, trajnime për standartet ndërkombëtare ISO dhe trajnime për sigurinë dhe shëndetin e punonjësve në punë sipas legjisllacionit shqiptar, inspektime mbi Konformitetin e ashensoreve, enëve dhe

pajisjeve nen presion, impianteve elektrike, makinerive dhe pajisjeve ngritese per sende dhe njerez, laborator per realizimin e testeve kimike, mikrobiologjike, testimeve mekanike, sigurise elektrike, analizave te ujit, tokes, ajrit dhe ushqimi por ne asnje moment nuk rezulton qe te kete objekt veprimtarie organizimin e kurseve profesionale apo te jete licensuar si qender formimi profesional.

Ne keto kushte K.V.O konstaton se deshmia e kualifikimit te paraqitur nga operatori ekonomik B 93 sh.p.k per permbushjen e kriterit te kerkuar ne DT (saldator), leshuar nga AQSCERT shoqeri e cila nuk ka objekt veprimtari qender formimi profesionale si dhe nuk eshte e njohur nga ministria perkatese per rrjedhoje jane te pavlefshme per shkak se kjo shoqeri nuk e ka tagrin ligjor dhe profesional per ti leshuar keto certifikata. Sqarojmë operatorin ekonomik se dokumenti qe duhet paraqitur per te deshmuar kualifikimin profesional jane; Certifikatat/dëshmitë/diplomat” te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar. Keto Certifikatat/dëshmitë/diplomat jane leshuar apo leshohen nga shkollat profesionale, apo qendrat e formimit profesional te cilat jane njohur e akredituar ligjerisht nga Agjencia e Formimit profesional sipas percaktimeve te ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” apo shkollat profesionale e qendrat e formimit qe kane egzistuar ne Shqiperi deri ne hyrjen ne fuqi te ligjit Nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Perfundimisht, KVO gjykon se per te deshmuar permbushjen e pikes 2.3.2/d te kriterëve te vecanta per kualifikim shtojca 12 e DST, operatoret duhet te paraqesin deshmitë se kane kualifikimin e nevojshme te perdorimit te pajisjeve elektrike te leshuara nga subjekte juridikë jo publikë (privatë), me kusht që këto të fundit të jenë të certifikuar (akredituar) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit si dhe deshmitë e kualifikimit profesional te cilat mund jene Certifikatat/dëshmitë/diplomat” te leshuara nga qendra formimi profesional, shkolla profesionale te njohura apo akredituara nga shteti.

Gjithashtu sqarojmë operatorin ekonomik se dëshmitë e kualifikimit profesional dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe lëshohen nga institucione të ndryshme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se kualifikimi i sigurimit teknik bëhet në përputhje me nenin 9 pika 1, gërma a) të ligjit nr.8734, datë 01.07.2001”Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike në të cilën parashikohet se.... Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj; e cila ka të bëjë me trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve elektrike, pavarësisht profesionit që mund të kenë.

Ndërsa dëshmia e kualifikimit profesional ka të bëjë me profesionin e secilit punonjës të cilat lëshohen nga institucione të ndryshme dhe që në asnjë rast nuk janë të njëjta me ato që lëshojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik. Përsa më sipër KVO gjykon se sipas % se marre persipër dhe natyres se punimeve, operatori B 93 shpk duhet te paraqiste deshmi kualifikimi profesional per se paku; nje elektro mekanik , nje hidraulik nje saldator.

8. Të skualifikojë BO për shkak se njëri nga operatorët ekonomikë dhe përkatësisht operatori ekonomik "Rafin Company" sh.p.k nuk kanë arritur të dëshmojnë përmbushjen e kriterit 2.3.4 .d të kriterëve të vecanta për kualifikim dhe konkretisht (nuk ka paraqitur deshmë kualifikimi profesional për profesionet elektromekanikë) Sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit operatori Rafin Company shpk ka marrë përsipër të kryejë 13,65 % të punëve ndërsa në aneksin e ndarjes puneve ka marrë përsipër të kryejë vendosje të punimeve elektromekanike.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar natyrës së punimeve të marra përsipër nga operatori ekonomik Rafin Company sh.p.k konstaton se në përmbushje të kriterit 2.3.4 pika d dhe përkatësisht profesionit elektromekanikë ka paraqitur kontratë pune nënshkruar me z.B.Petritaj datë 25.12.2018 shoqëruar me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik, si dhe certifikatë trajnimi të lëshuar nga AQSCERT.

Kështu nga verifikimet e kryera nga K.V.O në adresën qkb.gov.al për AQSCERT rezulton se në objektin e veprimtarisë së tij nuk ka e nuk është njohur nga ndonjë institucion shtetëror në rastin konkret nga ministria përkatëse e punës e drejta e tij për të organizuar kurse formimi profesional. Theksojmë se e drejta e organizimit të kurseve profesionale jepet me autorizim nga ish ministria e punës dhe mireqenies sociale.

Gjate shqyrtimit të ekstraktit historik të organizimit AQSCERT në adresën qkb.gov.al në objektin e veprimtarisë janë vlerësimiti i konformitetit të implementimit të standarteve ndërkombëtare ISO, trajnime për standartet ndërkombëtare ISO dhe trajnime për sigurinë dhe shëndetin e punonjësve në punë sipas legjislacionit shqiptar, inspektime mbi Konformitetin e ashensoreve, enëve dhe pajisjeve nën presion, impianteve elektrike, makinerive dhe pajisjeve ngritëse për sende dhe njerez, laborator për realizimin e testeve kimike, mikrobiologjike, testeve mekanike, sigurisë elektrike, analizave të ujit, tokës, ajrit dhe ushqimit por në asnjë moment nuk rezulton që të ketë objekt veprimtarie organizimin e kurseve profesionale apo të jete licensuar si qender formimi profesional. Në këto kushte K.V.O konstaton se deshmia e kualifikimit të paraqitur nga operatori ekonomik Rafin Company sh.p.k për përmbushjen e kriterit të kerkuar në DT (elektromekanik) lëshuar nga AQSCERT shoqëri e cila nuk ka objekt veprimtari qender formimi profesional si dhe nuk është e njohur nga ministria përkatëse për rrjedhojë janë të pavlefshme për shkak se kjo shoqëri nuk e ka tagrin ligjor dhe profesional për të lëshuar këto certifikata.

Sqarojmë operatorin ekonomik se dokumenti që duhet paraqitur për të deshmuar kualifikimin profesional janë ; Certifikatat/dëshmitë/diplomat" të cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar. Keto Certifikatat/dëshmitë/diplomat janë lëshuar apo lëshohen nga shkollat profesionale , apo qendrat e formimit profesional të cilat janë njohur e akredituar ligjrisht nga Agjencia e Formimit profesional sipas percaktimeve të ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" apo shkollat profesionale e qendrës e formimit që kanë egzistuar në Shqipëri deri në hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë".

Përfundimisht, KVO gjykon se për të deshmuar përmbushjen e pikës 2.3.2/d të kriterëve të vecanta për kualifikim shtojca 12 e DST , operatorët duhet të paraqesin deshmite se kanë kualifikimin e nevojshme të përdorimit të pajisjeve elektrike të lëshuara nga subjekte juridikë jo publikë (privatë)

,me kusht që këto të fundit të jenë të certifikuar (akredituar) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit si dhe deshmite e kualifikimit profesional të cilat mund jene Certifikatat/dëshmitë/diplomat” të leshuara nga qendra formimi profesional , shkolla profesionale të njohura apo akredituara nga shteti. Gjithashtu sqarojmë operatorin ekonomik se dëshmitë e kualifikimit profesional dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe lëshohen nga institucione të ndryshme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se kualifikimi i sigurimit teknik bëhet në përputhje me nenin 9 pika 1,gërma a)të ligjit nr.8734,datë 01.07.2001”Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike në të cilën parashikohet se.... Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj; e cila ka të bëjë me trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve elektrike, pavarësisht profesionit që mund të kenë. Ndërsa dëshmia e kualifikimit profesional ka të bëjë me profesionin e secilit punonjës të cilat lëshohen nga institucione të ndryshme dhe që në asnjë rast nuk janë të njëjta me ato që lëshojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik.

Përsa më sipër KVO gjykon se sipas % se marre persipër dhe natyres se punimeve operatori ekonomik “Rafin Company” shpk duhet te paraqiste deshmi kualifikimi profesional per se paku; nje elektromekanik.

Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;

Në nenin 53/3 të LPP-së parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

Përsa me sipër K.V.O vendos të skualifikojë ofertën e paraqitur nga BO” B-93 sh.p.k & Rafin Company & Arkon Studio sh.p.k,&Shëndelli sh.p.k.”

II.3. Në datën 24.07.2019, operatori ekonomik ankimes ka nisur me postë ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton s’kualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë “Be-Is” sh.p.k. Konkretisht pretendohet si vijon:

[...] Arsye Nr.1

1.Të skualifikojë BO “B 93” shpk “Arkon Studio “shpk “Rafin Company” shpk Shendelli”shpk për shkak se Operatori nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 1.a te kriterëve te vecanat per kualifikim. Kjo sepse Operatori nuk e ka plotesuar formularin e ofertes sipas formatit standart te shtojca 1 e DST por e ka ndryshuar ate .

Shtojca 1 e DST eshte formular standart dhe duhet plotesuar ne rubrikat e saj sic eshte percaktuar ne te. Pra duhet deklaruar vlera e ofertes pa tvsh dhe vlera e ofertes me tvsh si dhe tabela perkatese. Ne DST , Udhezime per operoret , seksioni 2 . Perllogaritje e ofertes ekonomike . pika 2.1 shprehimisht percaktohet ...

Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, Nderkohe qe, operatori ka paraqitur nje shtojce te ndryshuar duke deklaruar kater vlera te ndryshme oferte, e madje duke e ndare oferten ne elemente te ndryshem .

Deklarimi i bere nga operatori ne shtojca 1 te krijon perceptimin sikur kemi te bejme me dy lote te ndryshme brenda se njejtës procedure (njeri lot per punime ndertimi dhe nje lot per makineri pajisje) nderkohe qe ne fakt procedura objekt prokurimi eshte ne nje lot , ka nje preventiv (pavaresisht kapitujve e ndarjeve qe ka preventivi) dhe per rrjedhoje duhet te kishte paraqitur nje oferte me dy deklarime sipas shtojces 1 te DST ku duhet te kishte vetem nje deklarim per vleren e ofertes pa tvsh dhe nje deklarim me vleren me tvsh. Në rregullat e prokurimit , DST ,Kreu II “Udhëzime per operoret ekonomike”Seksioni 1 Hartimi i ofertës, ne piken 1.1 thuhet shprehimisht;

Citoj... 1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT.Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme .

2.Operatori ka paraqitur vleren e ofertes pa tvsh, duke e perlllogaritur ne kundërshtim me percaktimet e ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrisë të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” si dhe Udhëzimit nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. (formulari I ofertes I paraqitur nga operatori ka gabime ne perlllogaritjen e vleres pa tvsh) .

Konkretisht ;

Sipas formularit te ofertes , shtojca 1 e DST , operatori ka deklaruar cmimin e ofertes ne vleren 123 292 128 leke pa tvsh dhe cmimi i ofertes me tvsh ne vleren 147 950 554 leke .

Gjithashtu ne kete formular eshte deklaruar cmimi 16 387 243 leke me tvsh per makineri e pajisje dhe cmimi total i ofertes: ne vleren 164 337 797 leke me tvsh Por, operatori ka perlllogaritur gabim vleren e ofertes pa tvsh duke mosperfshire ne te vleren e pajisjeve te cilat sipas Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrisë të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” , duhet te perfshiheshin ne vleren e ofertes pa tvsh. Kjo sepse ;

Ne respekt të udhëzimit të sipërcituar, autoriteti kontraktor, në cilësinë e tatimpaguesit investitor ka parashikuar në preventiv se për zërin Makineri PAISJE nuk tatóhet dy herë në total me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Për sa kohë që paisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohej me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atëherë në ofertën qe duhet te paraqesnin operoret vlera totale e paisjeve duhet të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH.

Sa më sipër, gjykojmë se, në përlllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH në rastin e ketij objekti prokurimi , ku krahas punimeve te ndertimit ka edhe pajisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të duhej te ishte vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohej së bashku me TVSH), kjo duke u bazuar edhe në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Në këto kushte, gjykojmë se, vlera e ofertes ekonomike 123 292 128 leke pa TVSH e paraqitur nga BO, e cila është përlogaritur pa përfshire vleren e pajisjeve, është në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të sipërcituara. Nqs vlera e ofertes do te perllogaritej konform bazes ligjore ne fuqi, atehere vlera e ofertes se ketij BO do te ishte 139 679 371 leke pa tvsh. Pra shihet qarte se ka nje gabim ne perllogaritjen e deklarimin e ofertes pa tvsh ne Shumen 16 387 243 leke ose 11.7 % te vleres se ofertes pa tvsh. Nga ana tjetër, gjykojmë se përlogaritja dhe deklarimi I vleres ekonomike pa tvsh duke mospërfshire ne te vleren e pajisjeve shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik ofertues në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të kesaj procedure Ne kete rast KVO vepron konform percaktimeve te Vendimit KPP 600/2018 ne te cilen eshte shprehur qarte se, mosperفشirja e vleres se pajisjeve ne vleren e ofertes pa tvsh , eshte ndryshim i vleres se ofertes pa tvsh dhe perben shkak te ligjshem per skualifikim .

Argumetojme se:

B.O.E "B-93"shpk & "ARK.ON STUDIO"shpk & "RAFIN COMPANY" & "SHENDELLI"shpk ka paraqitur oferten e tij ne kete procedure, duke ju permbajtur rreptesisht formatit te preventivit te miratuar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Formati i preventivi i miratuar dhe i publikuar nga Autoritetit Kontraktor eshte:

SHUMA E (E1 - E2)	
SHUMA (A - E)	
FOND REZERVE 5%	
SHUMA (pa tvsh)	
TVSH (20%)	
SHUMA (me tvsh)	
E: MAKINERI DHE PAISJE	
SHUMA MAKINERI DHE PAISJE (ME TVSH) F (F1 - F2)	
VLERA TOTALE E INVESTIMIT	leke

Oferta e paraqitur nga ana jone eshte ne perputhje te plote dhe pa devijuar nga formati i preventivit te publikuar ne sistem.

Oferta e paraqitur nga ana jone eshte detajuar sipas formatit te preventivit:

Shuma	117,421,074 leke
Fondi Rezerve 5%	5,871,054 leke
Shuma pa tvsh	123,292,128 leke
Tvsh 20 %	24,658,426 leke
Shuma me tvsh	147,950,554 leke
Makineri pajisje	16,387,243 leke
Vlerat Totale	164,337,797 leke

Ku sic shihet objektivisht vlera e pajisjeve e cila e ka brenda TVSH-ne, i mblidhet shumes me tvsh te objektit.

Po te njejtin parim kemi respektuar dhe ne plotesimin e formularit te ofertes, shtojca 1.

Persa i perket pretendimit tuaj se " Operatori nuk e ka plotesuar formularin e ofertes sipas formatit standard te shtojca 1 e DST por e ka ndryshuar ate", gjithashtu ne formularin e

preventivit te miratuar nga ana juaj si Autoritet Kontraktor nuk i'a keni mbledhur vleren e pajisjeve edhe shumes pa tvsh te objektit, por i'a keni mbledhur vetem shumes me tvsh. Duke qene se formati juaj i preventivit vlera e pajisjeve ka te pasqyruar se vlera e pajisjeve i mbidhet vetem vleres me tvsh dhe prej kesaj rezulton vlera totale e objektit.

B.O.E ne formularin e ofertes ka respektuar formatin e miratuar nga ana juaj te preventivit. Deduktimet personale "... Deklarimi i bere nga operatori ne shtojca 1 te krijon perceptimin sikur kemi te bejme me dy lote te ndryshme brenda se njejtës procedure (njeri lot per punime ndertimi dhe nje lot per makineri pajisje) nderkohe qe ne fakt procedura objekt prokurimi eshte ne nje lot, ka nje preventiv (pavaresisht kapitujve e ndarjeve qe ka preventivi) ... ", le te ngelen personale, pasi jane opinione vetjake, pa asnje mbeshtetje ligjore dhe per me teper me ngjyrim dashakeqese paragjyqese.

Duam tju risjellim ne vemendje se formati i formularit te ofertes, Shtojca 1, pjese perberese e dokumentave standarde te tenderit, nuk ka te pasqyruar ne te pjesen e pajisjeve, kur ne preventiv pajisjet jane kapitull me vete.

Rrjedhimisht formati i formularit te ofertes, Shtojca 1, do te kete plotesime. Kjo per tu perputhur me formatin e preventivit te miratuar dhe te publikuar nga ana juaj.

Pretendimi juaj se eshte ndryshuar formulari i ofertes sipas formatit standard te shtojca 1 e DST, nuk qendron pasi asnje element i formatit standard te shtojca 1 e DST te kesaj procedure nuk eshte ndryshuar. Formulari i ofertes nuk eshte ndryshuar por eshte plotesuar me te dhena te nevojshme, te cilat i mungonin asaj te publikuar nga ana juaj.

Vetem nga ana juaj mund te degjosh kete absurditet pasi ne, formatin qe kemi paraqitur ne tenderin tuaj, e kemi derguar edhe ne tendera te tjere dhe ne asnje rast nuk jemi skualifikuar.

1. Rikonstruksion i merkatos se tregtimit te peshkut me shumice, Shengjin me autoritet kontraktor Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural,

2. Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare Armath, Manez me autoritet kontraktor Bashkia Durres,

3. Rehabilitimi i qendres Administrative Baldushk (Rikonstruksion i godines se Njesise, shtepise kultures dhe sheshit) me autoritet kontraktor Bashkia Tirane.

Arsyeja juaj nuk qendron, pasi nuk ka asnje baze ligjore dhe eshte ndertuar mbi deduktime personale, te cilat te largojne ne menyre te qellimshme nga thelbi i ofertes [...].

Arsye Nr. 2

Të skualikojë BO për shkak se operatori ekonomik ka perlllogaritur page orare per nje pjese te zerave te preventivave e cila është nën minimumin ligjor të lejuar.

Keshtu , ne analizat e cmimeve te paraqitura , rezulton se paga orare per nje pjese te zerave te punes qe parashikon preventivi i procedurës objekt prokurimi dhe konkretisht zërat nr.analiz 3.46/1 ; 3.47/1c , 3.377 , 2.37/5b , 2.1b, 3.47/1b , 2.258, 164/1a, 2.426/4, 2.426/3 , An9, heqja e shtrese izoluese egzistuese , 2.258/2, An cmontim heqje dyer dritare , An heqje shtrese dysHEMEJE, An heqje shtrese suvatimi ne mure te brendshme , An heqje shtrese suvatimi ne mure te jashtme , An heqje shtrese suvatimi ne tavane , etj janë përlllogaritur me 125 lekë/op.

Ne nenin 11 te K Punes percaktohet;...PAGA MINIMALE ..Paga nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në V.K.M nr. 809 datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", përcaktohet shprehimisht: "Paga bazë

minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 26.000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 149 (njëqind e dyzetë e nëntë) lekë.

Pra, duke qenë se paga orare minimale duhet të jetë 149 lekë, llogaritjet e bëra në analizat e paraqitura për pagën orare në masën 125 lekë , bien në kundërshtim me vendimin e mësipërm.

Skualifikimi për këtë arsye të perlllogartijes se gabuar të pages orare mbeshet në vendimet e KPP, si psh KPP 313/2014; KPP 819/2016 etj .

Skualifikimi për këtë arsye është konsideruar i ligjshëm edhe nga APP në rastin e propozimeve të KLSHse për auditimin e kryer në Bashkinë Kelcyre.

Në rregullat e prokurimit dhe Praktiken e vendimarrjeve të KPP theksohet se mosplotesimi qoftë edhe një kriteri të vetëm përben shkak për skualifikim të operatorit.

Argumentojmë se:

Baza ligjore në fuqi dhe e vetmja për hartimin e analizave teknike të cmimeve është "Manuali teknik i cmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike" të miratuara me Vendim të KM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike të tyre".

Pretendimi juaj se analizat teknike të cmimeve respektivisht për zerat nr.analiz 3.46/1 ; 3.47/lc, 3.377, 2.37/5b , 2.1 b, 3.47/1 b , 2.258, 164/la, 2.426/4, 2.426/3 , An9, heqja e shtrese izoluese egzistuese, 2.258/2, An cmontim heqje dyer dritare, An heqje shtrese dysHEMEJE, An heqje shtrese suvatimi në mure të brendshme, An heqje shtrese suvatimi në mure të jashtme, An heqje shtrese suvatimi në tavane janë të pasakta nuk qëndron.

Kjo sepse:

Projekti dhe preventivi i zbatimit të objektit të prokurimit "Ndertimi i Rrjetit të Jashtëm të Ujesjellesit Kelcyre", i realizuar nga shoqëria "Zenit & Co" shpk është miratuar nga porositësi Bashkia Kelcyre në vitin 2019.

Vlera e objektit është llogaritur nëpërmjet projekt preventivit të tij. Pjesë përberëse e preventivit janë edhe analizat teknike të cmimeve për zerat që nuk janë në preventiv.

Preventivi i këtij objekti është hartuar duke u bazuar në VKM-ne nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike të tyre ", ku cmimi i punëtorisë së pakualifikuar është 125 leke/op.

Nëpërmjet kësaj llogaritje është përcaktuar edhe fondi limit i objektit.

B.O.E "B-93" shpk & "ARK ON STUDIO" shpk & "RAFIN COMPANY" & "SHENDELLI" shpk në përgatitjen e ofertës së tij është mbeshetur në të njëjten bazë ligjore, në të cilën është miratuar edhe projekt-preventivi i zbatimit të objektit.

Autoriteti Kontraktor në fazën e miratimit projektit ka pranuar dhe miratuar analizat e cmimeve me 125 leke/op për punëtorinë e thjeshtë dhe në fazën e vlerësimit të ofertave për zbatimin e objektit nxjerr pretendime të tjera, duke rënë ndesh me vendimarrjen e tij. Theksojmë se edhe miratimi i projekt-preventivit të objektit të prokurimit është bërë po në vitin 2019 ndërkohe që VKM nr. 809 datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi" ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2019.

Pra ndodhemi ne te njejtat kushte ligjore por ne interpretime te ndryshme te tyre.

Handikapi i krijuar midis VKM-ne nr. 629, date 15.07.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve e ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" dhe V.K.M nr. 809 date 26.12.2018 "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi" eshte ceshtje e institucioneve ligjberese. Argumentimet e KVO-se bien ndesh me vendimet e po te njejtit Autoritet Kontraktor, ne lidhje me te njejtin objekt.

Arsye nr.3

Operatori nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te sakte per te deshmuar plotesimin pikes I te kritereve te pergjithshme per kualifikim (per rastin kur oferta paraqitet si bashkim operatoresh) si dhe percaktimeve te nenit 74 te VKM 914 date 29.12.2014 ku shprehimisht thuhet:

“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Operatori ka paraqitur kontraten noteriale te bashkepunimit te dates 25.06.2019 me nr 3153 rep dhe nr 1395 kol si dhe prokuren e posacme po e dates 25.06.2019. Sipas nenit 3 te kesaj marreveshje bashkepunimi, ku eshte dakortuesuar % e ndarjes se punimeve, palet kane percaktuar se elementet konkrete te punimeve qe do të kryeje sejcili prej pjesetareve te ketij bashkimi eshtë e percaktuar ne aneksin 1 bashkelidhur kontrates .

Nga shqyrtimi i aneksit nr.1 konstatohet lehtesisht se aneksi nr. 1 nuk ka nenshkrimin dhe vulen e perfaqesuesve anetare te ketij bashkimi operatoresh. Mungesa e nenshkrimeve dhe vules se sejcilit prej anetareve de jure dhe de facto deshmon se ky Bashkim operatoresh nuk arrin te paraqese dokumentacion te plote dhe te rregullt per elementet konkret qe do kryeje sejcili pjesetar i BO.Sipas percaktimeve te nenit 74 pika 2 i VKM nr.914”Rregullat e Prokurimit Publik”I ndryshuar preventivi i ndarjes se punimeve (percaktimi i elementeve konkrete qe do te kryeje secili pjesetar I BO)duhet të firmoset dhe vuloset nga secili prej anetareve te BO.

Fakti i mesiperm perben arsye ligjore per ta kondideruar te parregullt marreveshjen e bashkepunimit midis operateve ekonomike kjo referuar kreut 8 nenit 74 pika 2 e VKM. nr.914”Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Por gjithashtu edhe kontrata e bashkepunimit dhe prokura e posacme ne faqen e fundit te aktit noterial nuk kane vendosur me shkrimin e tyre

emrin dhe mbiemrin e tyre por thjesht e vetem nenshkrimin. Kjo eshte ne kundersizim me percaktimet e nenit 102 pika 1 te ligjit 110/2018 " Per noterine " ku shprehimisht percaktohet ; aktet noteriale nenshkruhen rregullisht nga pjesemarrësit në aktin noterial, në prani të noterit, pasi noteri ka hartuar aktin dhe ua ka bërë të ditur përmbajtjen e tij palëve. Nenshkrimi shoqërohet me emrin dhe mbiemrin e plotë të palëve. Palët vendosin nenshkrimin e tyre në çdo faqe të aktit noterial dhe në fund të aktit noterial vendosin emrin, mbiemrin, si dhe nenshkrimin e tyre.

Argumentojmë se:

B.O.E "B-93 "shpk & "ARK ON STUDIO"shpk & "RAPIN COMPANY" & "SHENDELLI"shpk ka shprehur interesin per proceduren e prokurimit objekt te kesaj ankese, duke paraqitur oferten e saj. B.O.E eshte krijuar si nje shoqeri e vetme nepermjet "Kontrate Bashkepunimi per Bashkimin e Perkohshem te shoqerise" me nr 3153 rep dhe nr 1395 si dhe prokuren e posacme me nr 3154 rep dhe nr 1396, te nenshkruara nga palet me date 25.06.2019 dhe te lidhur para noteres E.M.

Kontrata e bashkepunimit dhe Prokura permbushin te gjitha kriteret ligjore te percaktuara ne ligjin Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimit Publik" dhe VKM nr 914, date 29.12.2014, ku jane shprehur kushtet e bashkimit, menyra e funksionimit, ndarja e punimeve, te drejtat dhe detyrimet e te gjitha paleve.

Pasi palet pasi kane rene dakort per te gjitha elementet e Kontrates se Bashkepunimit dhe Prokures se Posacme, ata e kane nenshkruar dhe e kane legalizuar nenshkrimin e tyre me vule ne prani te noteres. Pas nenshkrimit te te gjitha paleve ky dokument i ka marre te gjitha fuqite ligjore dhe perfaqesuese ne cdo institucion.

Ndarja e punimeve eshte dakortesuar ndermjet paleve dhe ne prani te noteres eshte bere ligjerimi i saj nepermjet vules se noteres, duke fituar keshtu fuqine ligjore.

Argumenti qe ndarja e punimeve duhej te nenshkruhej nga te gjitha palet eshte i dobet, pasi eshte i pambeshtetur ne ligj dhe eshte nje rrjedhim logjik subjektiv i KVO-se.

Anekset te cilat duhet te nenshkruhen nga palet jane shtojca apo amendament te cilat kane ne permbajtje te tyre ndryshime dhe shtime te pikave apo kushteve te percaktuara ne kontraten baze.

Konkretisht jemi perballe nje "aneksi" i cili nuk ka bere asnje me shume se detajimin e kushteve te ndarjes se punimeve, te cilat jane te mirepercaktuara ne nenin 3 te kontrates se bashkepunimit. Pra nuk kemi asnje ndryshim apo shtim te kushteve te kontrates baze per te cilat do te ishte e detyruar nenshkrimi nga palet.

Argumentimi i KVO-se eshte absurd per te skualifikuar BOE.

Arsye nr.4

Nje nga pjesetaret e ketij BO, konkretisht operatori B 93 shpk ka paraqitur dokumentacion te pasakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.1 te kriterëve te vecanta per kualifikim . Ne kete pike eshte kerkuar ;

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

c) Punë të ngjashme e realizuar ne një kontrate te vetme me vlerë sa 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit(perllogaritur nga data e zhvillimit te tenderit) ose

d) punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e kontratave te punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit (perllogaritur nga data e zhvillimit te tenderit) është në një vlerë sa dyfishi i e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pra, sipa spercaktimeve te mesieprme, perllogaritja e afatit tre vjecar do te behet referuar dt hapjes ofertave Sipas akt marreveshjes bashkepunimit operatori B 93 shpk ka marre persiper te kryeje 54.03 % te punimeve . Ne zbatim te percaktimeve te nenit 74 te VKM 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar si pjese e BO duhet qe kriterin per pune te ngjashme si nje kriter qe ben pjese tek kapacitetet teknike duhet ta plotesonte ne perputhje me % e marre persiper ne akt marreveshje.

Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri operatori B 93 shpk ka paraqitur edhe kontraten "Ndertim ujesjellesi te fshatit Corrush Anberg " kontrate baze +shtese kontrate .

Kontrata baze është realizuar ne vleren 75 925 925 leke pa tvsh dhe shtese kontrata ne vleren 14 262 398 leke pa tvsh. Krahas kontratave, operatori ka paraqitur edhe dokumentacionin bashkelidhur si formular vleresimi e faturat tatimore. Nga ky dokumentacion rezulton se, punimet e kontrates baze jane realizuar jashte afatit ligjor tre vjecar te vlefshme per te deshmuar realizimin e kontratave te ngjashme. Kjo sepse, sic deshmohet ne formularin e vleresimit kontrata baze ka perfunduar me daten 11.04.2016 nderkohe qe dt e hapjes ofertave eshte data 26.06.2019.

Po keshtu edhe nga faturat tatimore te kontrates baze te paraqitura rezultojne se jane jashte afatit tre vjecar te percaktuar ne rregullat e prokurimit. Nga shqyrtimi i faturave të paraqitura rezulton se fatura me e fundit e me afer dt. hapjes ofertave eshte data 01.05.2016 .

Sa më sipër, KVO gjykon se, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit, kontrata bazë ujesjellesit paraqitur nga B 93 shpk konsiderohet jashtë afatit 3 vjeçar të parashikuar nga neni 26 pika 6 e VKM 914/2014, duke mos përmbushur kriterin e kualifikimit në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë.

Ne perllogaritjen e ketij afati trevjecar, KVO i referohet praktikës se vendimarrjeve te KPP sic është rasti i K.P.P. 521/2016, K.P.P. 874/2016 etj.

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur gjithashtu edhe kontratat me objekt "Rikostruksioni i Rrugës Pisheporo Bregdet, Njësia Administrative Levan", nënshkruar me AK Bashkia Fier datë 10.11.2017, kontratën me objekt "Rruga Dejë Qendër", nënshkruar me AK Bashkia Vau Dejës datë 13.05.2017. Referuar kontratave të paraqitura të sipërcituara nga B93 shpk nuk jane te natyres se ngjashme me kontraten objekt prokurimi. Nga shqyrtimi i kontratave të paraqitura rezulton se janë per ndertim apo rikonstruksion rruge ndërsa ndërsa kontrata objekt prokurimi eshte ndertim rrjet ujesjellesi.



Në këto kushte operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë se disponon kapacitetet teknike, përvojën e duhur në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar kontratën objekt prokurimi për arsye se vlera e kontratës së vetme te vlefshme (shtesë kontrate "Ndertim ujesjellesi te fshatit Corrush Anberg") nuk arrin vlerën e kërkuar as në germën a) të pikës 2.3.1 a dhe pikën 2.3.1 b) të DST.

Argumentojmë se:

Puna e ngjashme e paraqitur nga Shoqeria "B-93" sh.p.k eshte konform cdo legjislacioni dhe kriteresh te percaktuar ne ligjin per Prokurimet publike.

Duket mjaft qarte qe KVO-ja ne deshperim te thelle ka gjetur "arsyet" edhe pse s'mund te quhen te tilla qe te na skualifikoje.

Po ju rikujtojme qe te jeni me te vemendeshme duke vleresuar cdo dokument te paraqitur nga nje OE, konkretisht ne rastin tone ne faqen 43 te dosjes me emertimi "Pune e ngjashme Ujesjelles Corrush Baze +Shtese OK" eshte Akti i kolaudimit te objektit.

<i>Objektit:</i> " NDERTIM I RRJETIT TE UJESJELLESIT TE FSHATIT ÇORRUSH - ANBREG + KONTRATA SHITESE "	
<u>PROCESVERBAL - KOLAUDIMI</u>	
Ne baze te ligjit Nr.8402 dt.10/09/2001 "Per kontrollin dhe disiplinimin e ndertimeve" dhe udhezimit te KM Nr.3 dt.15/02/2001 per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit, sot me <u>date 15/02/2017</u> , hartohet proces verbali i akt-kolaudimit te objektit	
<u>" NDERTIM I RRJETIT TE UJESJELLESIT TE FSHATIT ÇORRUSH - ANBREG "</u>	
Vendi i ndertimit:	Fshati ÇORRUSH.
Sipërmarrësi i Punimeve:	B.O "B-93"shpk & "BE-IS"shpk
Përfaqësuar:	Z. Shpetim LIÇAJ, Administratori i "B-93"shpk
Mbikqyres i objektit:	"ERSI/M" Shpk
Përfaqësuar:	Ing. Gezim GOXHAI
Kolaudatori i objektit:	Ing. Natasha MYRTAJ
<u>Të dhëna për objektin dhe për zbatimin e kontratës:</u>	
• Investitor:	<u>SHA Ujesjelles Kanalizime-Mallakaster.</u>
• Enti prokurues:	<u>SHA Ujesjelles Kanalizime-Mallakaster.</u>
• Data e Fillimit të Punimeve sipas kontrates Baze:	date: 05 / 09 / 2015
• Data e Përfundimit të Punimeve sipas Kontrates Baze	date: 05 / 11 / 2015
• Data e Përfundimit të Punimeve sipas Amendamentit	date: 05 / 09 / 2016
• Data e Përfundimit te punimeve	date: 11 / 04 / 2016
• Afati eshte shtyre:	Po
• Arsyeja e shtyrjes eshte:	Amendim kontrate Mungese fondesh
• Penalitete:	Nuk ka
 NATASHA MYRTAJ PROJEKTIM DREJTIM KOLAUDIM  1	

Objektit:
" NDERTIM I RRJETIT TE UJESJELLESIT TE FSHATIT ÇORRUSH - ANBREG
KONTRATA SHITESE "

- *Data e Fillimit të Punimeve sipas kontrates Shtese:* date: 09 / 12 / 2016
- *Data e Përfundimit të Punimeve sipas Kontrates Shtese* date: 09 / 02 / 2017
- *Data e Përfundimit të Punimeve* date: 09 / 02 / 2017
- *Afati është shtyre:* Po
- *Arsyeja e shtyrjes është:* Amendim kontrate
Mungese fondesh
- *Penalitet:* Nuk ka
- *Data e kërkesës së Kolaudimit* date 15.02.2017

Vlera e kontratës së nënshkruar midis Investitorit, SH.A Ujesjelles Kanalizime-Mallakaster të përfaqësuar nga drejtori Z. Erjon ZENELAJ dhe firmave sipërmarrëse B.O "B-93"shpk & "BE-IS"shpk të përfaqësuar nga Z. Shpëtim LIÇAJ, administratori i "B-93"shpk, është :

Vlera totale e preventivit sipas kontrates Baze është 91'111'111 (nëntëdhjetë e një milion e njëqind e njëmbëdhjetë e një mijë e njëqind e njëmbëdhjetë e një) leke me TVSH.

Vlera totale e preventivit sipas kontrates Shtese është 17'130'078 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë mijë e shtatëdhjetë e tetë) leke me TVSH

Vlera e punimeve të kryera në fakt sipas situacioneve pjesore dhe situacionit përfundimtar është:

Vlera totale e punimeve sipas kontrates Baze është 91'111'111 (nëntëdhjetë e një milion e njëqind e njëmbëdhjetë e një mijë e njëqind e njëmbëdhjetë e një) leke me TVSH

Vlera totale e punimeve sipas kontrates Shtese është 17'114'878 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e katërmëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) leke me TVSH.

Kolaudimi bëhet mbi bazën e katër dokumenteve:

- Proces-verbali i Dorezimit të Sheshit të Ndertimit dhe i Fillimit të Punimeve.
- Proces-verbali i Fillimit të Punimeve.
- Njoftim i Sipërmarrësit për Fillimin e Punimeve.
- Njoftim i Mbikqyresit të Punimeve për Fillimin e Punimeve.

NATASHA MYRTAJ
PROJEKTIM DREJTIM


2

Ky akt është hartuar/mbajtur në dt 15.02.2017, date kjo e cila do të filloj dhe numerin për afatin 3 vjeçare, afat ky i cili nuk është ezauruar dhe që sjelle legjitimin e paraqitjes së

kesaj pune te ngjashme nga Shoqeria "B-93" sh.p.k pasi kontrata shtese trajtohet pjese perberese e kontrates baze theksojme teknikisht qe nje veper nuk mund te vihet ne shfrytezim nese ajo nuk perfundon e si nje e tere dhe Autoriteti kontraktor e ka kolauduar objektin ne kete date.

Gjithashtu nese do te ishit me te vemendeshme do te kishit konstatuar se ne situacioni e kontrates shtese ka zera te trasheguara nga kontrata baze.

Si eshte e mundur qe KVO-ja mund te beje skualifikime per arsye qe nuk jane te parashikuara ne Dokumentat te tenderit dhe te shkele hapur nenin 55 pika 2 te ligjit per prokurimet publike " ndryshuar?

Pra arsyeja per mbarimin e afatit 3 vjecare te kontrates hidhet poshte me nje logjike te thjeshte dhe duke gene pak me shume te vemendeshem.

Arsye nr.5

Njëri nga pjesetaret e ketij BO, konkretisht operatori B 93 shpk nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plotë dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.4.d te kriterëve te vecanta per kualifikim dhe konkretisht (nuk ka paraqitur deshmi kualifikimi profesional per profesionet elektromekanike, mekanike dhe hidraulike) Sipas akt marrëveshjes së bashkepunimit operatori B 93 shpk ka marre persipër te kryejë 54.03% të punëve ndërsa ne aneksin e ndarjes puneve ka marre persipër te kryeje punime hidraulike ,elektrike ,mekanike .

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik B 93 sh.p.k ka paraqitur kontratë pune me palë z.V.Calaj datë 24.06.2019 punësuar si elektromekanik shoqëruar me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur komisioni i vlerësimit të ofertave evidenton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit. Gjithashtu në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST përse i përket profesionit hidraulik operatori ekonomik ka paraqitur kontratë pune datë 07.05.2019 me palë z.A.Licaj shoqëruar me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur komisioni i vlerësimit të ofertave evidenton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar natyrës së punimeve të marra përsipër nga operatori ekonomik B 93 sh.p.k konstaton se në përmbushje të kriterit 2.3.4 pika d dhe përkatësisht profesionit saldator ka paraqitur kontratë pune nënshkruar me z.P.Caushaj datë 01.05.2017 shoqëruar me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, si dhe çertifikatë trajnimi lëshuar nga AQSCERT.

Keshtu nga verifikimet e kryera nga K.V.O ne adresen qkb.gov.al per AQSCERT rezulton se ne objektin e veprimtarise se tij nuk ka e nuk eshte njohur nga ndonje institucion shteteror ne rastin konkret nga ministria perkatese e punes e drejta e tij per te organizuar kurse formimi profesional. Theksojme se e drejta e organizimit te kurseve profesionale jepet me autorizim nga ish ministria e punes dhe mireqenies sociale.

Gjate shqyrtimit te ekstraktit historik te organizmit AQSCERT ne adresen ëëë.qkb.gov.al ne objekt te veprimtarise jane vleresimi i konformitetit te implementimit te standarteve nderkombetare ISO,

trajtime per standartet nderkombetare ISO dhe trajtime per sigurine dhe shendetin e punonjesve ne pune sipas legjislacionit shqiptar, inspektime mbi Konformitetin e ashensoreve, eneve dhe pajisjeve nen presion, impianteve elektrike, makinerive dhe pajisjeve ngritese per sende dhe njerez, laborator per realizimin e testeve kimike, mikrobiologjike, testimeve mekanike, sigurise elektrike, analizave te ujit, tokes, ajrit dhe ushqimi por ne asnje moment nuk rezulton qe te kete objekt veprimtarie organizimin e kurseve profesionale apo te jete licensuar si qender formimi profesional.

Ne keto kushte K.V.O konstaton se deshmia e kualifikimit te paraqitur nga operatori ekonomik B 93 sh.p.k per permbushjen e kriterit te kerkuar ne DT (saldator), leshuar nga AQSCERT shoqeri e cila nuk ka objekt veprimtari qender formimi profesionale si dhe nuk eshte e njohur nga ministria perkatese per rrjedhoje jane te pavlefshme per shkak se kjo shoqeri nuk e ka tagrin ligjor dhe profesional per ti leshuar keto certifikata. Sqarojmë operatorin ekonomik se dokumenti qe duhet paraqitur per te deshmuar kualifikimin profesional jane; Certifikatat/dëshmitë/diplomat” te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar. Keto Certifikatat/dëshmitë/diplomat jane leshuar apo leshohen nga shkollat profesionale, apo qendrat e formimit profesional te cilat jane njohur e akredituar ligjerisht nga Agjencia e Formimit profesional sipas percaktimeve te ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” apo shkollat profesionale e qendrat e formimit qe kane egzistuar ne Shqiperi deri ne hyrjen ne fuqi te ligjit Nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Perfundimisht, KVO gjykon se per te deshmuar permbushjen e pikes 2.3.2/d te kriterave te vecanta per kualifikim shtojca 12 e DST, operatoret duhet te paraqesin deshmitë se kane kualifikimin e nevojshme te perdorimit te pajisjeve elektrike te leshuara nga subjekte juridike jo publike (privatë), me kusht që këto të fundit të jenë të certifikuar (akredituar) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit si dhe deshmitë e kualifikimit profesional te cilat mund jene Certifikatat/dëshmitë/diplomat” te leshuara nga qendra formimi profesional, shkolla profesionale te njohura apo akredituara nga shteti.

Gjithashtu sqarojmë operatorin ekonomik se dëshmitë e kualifikimit profesional dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe lëshohen nga institucione të ndryshme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se kualifikimi i sigurimit teknik bëhet në përputhje me nenin 9 pika 1, gërma a) të ligjit nr.8734, datë 01.07.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike në të cilën parashikohet se.... Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj; e cila ka të bëjë me trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve elektrike, pavarësisht profesionit që mund të kenë.

Ndërsa dëshmia e kualifikimit profesional ka të bëjë me profesionin e secilit punonjës të cilat lëshohen nga institucione të ndryshme dhe që në asnjë rast nuk janë të njëjta me ato që lëshojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik. Përsa më sipër KVO gjykon se sipas % se marre

persipër dhe natyres se punimeve, operatori B 93 shpk duhet te paraqiste deshmi kualifikimi profesional per se paku; nje elektro mekanik , nje hidraulik nje saldator.

8.Të skualifikojë BO për shkak se njëri nga operatorët ekonomikë dhe përkatësisht operatori ekonomik “Rafin Company” sh.p.k nuk kanë arritur të dëshmojnë përmbushjen e kriterin 2.3.4 .d te kriterëve te vecanta per kualifikim dhe konkretisht (nuk ka paraqitur deshmi kualifikimi profesional per profesionet elektromekanikë) Sipas akt marrëveshjes së bashkepunimit operatori Rafin Company shpk ka marre persipër te kryejë 13,65 % të punëve ndërsa ne aneksin e ndarjes puneve ka marre persipër te kryeje vendosje të punimeve elektromekanike.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave referuar natyrës së punimeve të marra përsipër nga operatori ekonomik Rafin Company sh.p.k konstaton se në përmbushje të kriterit 2.3.4 pika d dhe përkatësisht profesionit eletromekanikë ka paraqitur kontratë pune nënshkruar me z.B.Petritaj datë 25.12.2018 shoqëruar me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik,si dhe çertifikatë trajnimi lëshuar nga AQSCERT.

Keshtu nga verifikimet e kryera nga K.V.O ne adresen qkb.gov.al per AQSCERT rezulton se ne objektin e veprimtarise se tij nuk ka e nuk eshte njohur nga ndonje institucion shteteror ne rastin konkret nga ministria perkatese e punes e drejta e tij per te organizuar kurse formimi profesional. Theksojme se e drejta e organizimit te kurseve profesionale jepet me autorizim nga ish ministria e punes dhe mireqenies sociale.

Gjate shqyrtimit te ekstraktit historik te organizmit AQSCERT ne adresen qkb.gov.al ne objekt te veprimtarise jane vleresimi i konformitetit te implementimit te standarteve nderkombetare ISO, trajnime per standartet nderkombetare ISO dhe trajnime per sigurine dhe shendetin e punonjesve ne pune sipas legjislacionit shqiptar, inspektime mbi Konformitetin e ashensoreve, eneve dhe pajisjeve nen presion, impianteve elektrike, makinerive dhe pajisjeve ngritese per sende dhe njerez, laborator per realizimin e testeve kimike, mikrobiologjike, testimeve mekanike, sigurise elektrike, analizave te ujit, tokes, ajrit dhe ushqimi por ne asnje moment nuk rezulton qe te kete objekt veprimtarie organizimin e kurseve profesionale apo te jete licensuar si qender formimi profesional. Ne keto kushte K.V.O konstaton se deshmia e kualifikimit te paraqitur nga operatori ekonomik Rafin Company sh.p.k per permbushjen e kriterit te kerkuar ne DT(elektromekanik) leshuar nga AQSCERT shoqeri e cila nuk ka objekt veprimtari qender formimi profesionale si dhe nuk eshte e njohur nga ministria perkatese per rrjedhoje jane te pavlefshme per shkak se kjo shoqeri nuk e ka tagrin ligjor dhe profesional per ti leshuar keto certifikata.

Sqarojmë operatorin ekonomik se dokumenti qe duhet paraqitur per te deshmuar kualifikimin profesional jane; Certifikatat/dëshmitë/diplomat” te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar. Keto Certifikatat/dëshmitë/diplomat jane leshuar apo leshohen nga shkollat profesionale, apo qendrat e formimit profesional te cilat jane njohur e akredituar ligjerisht nga Agjencia e Formimit profesional sipas percaktimeve te ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” apo shkollat profesionale e qednrt e formimit qe kane egzistuar ne Shqiperi deri ne hyrjen ne fuqi te ligjit Nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Perfundimisht, KVO gjykon se per te deshmuar permbushjen e pikes 2.3.2/d te kriterëve te vecanta per kualifikim shtojca 12 e DST , operatorët duhet te paraqesin deshmitë se kane kualifikimin e nevojshme te perdorimit te pajisjeve elektrike te leshuara nga subjekte juridike jo publike (privatë), me kusht që këto të jenë të certifikuar (akredituar) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit si dhe deshmitë e kualifikimit profesional te cilat mund jene Certifikatat/dëshmitë/diplomat” te leshuara nga qendra formimi profesional , shkolla profesionale te njohura apo akredituara nga shteti. Gjithashtu sqarojmë operatorin ekonomik se dëshmitë e kualifikimit profesional dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe lëshohen nga institucione të ndryshme. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave thekson se kualifikimi i sigurimit teknik bëhet në përputhje me nenin 9 pika 1, gërma a) të ligjit nr.8734, datë 01.07.2001” Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike në të cilën parashikohet se.... Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj; e cila ka të bëjë me trajnimin e punonjësve për përdorimin e pajisjeve elektrike, pavarësisht profesionit që mund të kenë.

Ndërsa dëshmia e kualifikimit profesional ka të bëjë me profesionin e secilit punonjës të cilat lëshohen nga institucione të ndryshme dhe që në asnjë rast nuk janë të njëjta me ato që lëshojnë dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik.

Përsa më sipër KVO gjykon se sipas % se marre persipër dhe natyres se punimeve operatori ekonomik “Rafin Company” shpk duhet te paraqiste deshmi kualifikimi profesional per se paku; nje elektromekanik.

Argumentojme se:

Jo vetem ne si shoqeri apo Bashkimi yne i Operatoreve por asnje shoqeri tjetër nuk ka mundesine apo edhe detyrimin te hetoje kompani te cilat "mund" te leshojne dokumenta te cilat jane apo KVO mund ti quaje te pavlefeshme.

Ky argument duhet te rrezohet.

Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë “Be-Is” sh.p.k.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 1630 prot., datë 30.07.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën, pasi është paraqitur në AK jashtë afateve ligjore, si më poshtë vijon:

“[...] Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi mori ne shqyrtim ankesen e paraqitur nga ana juaj, konstatoi se ne daten 30.07.2019, nepermjet sherbimit postar, bashkimi i operatoreve ekonomike ankimes ka dorezuar ankim prane autoritetit kontraktor me ane te te cilit kundershton vendimin e KVO-se per skualifikimin e ofertes se tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi mori ne shqyrtim dosjen e prokurimit me objekt "Ndertimi i Rrjetit te Jashtem te Ujesjellesit Kelcyre" veren se:

Vleresimi i procedures objekt prokurimi eshte kryer ne sistemin elektronik me date 22.07.2019 nderkohe qe ankesa me shkrim nga ana juaj ka mberritur prane Bashkise Kelcyre me date 30.07.2019 (vertetuar kjo edhe nepermjet sherbimit postar).

Referuar ankeses se paraqitur nga ana juaj prane AK, Bashkia Kelcyre, K.SH.A konstatohet se ankesa juaj per proceduren e prokurimit me objekt "Ndertimi i Rrjetit te Jashtem te Ujesjellesit Kelcyre", me fond limit 151,169,770 (njqind e pesedhjete e nje milion e njqind e gjashtedhjete e nente mije shtateqind e shtatedhjete) leke pa tvsh eshte jashte afateve ligjore te parashikuara ne ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik".

Ne ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", neni 63 pika 1, 2, dhe 5, shprehimisht parashikohet se "Cdo person qe ka ose ka pasur interes ne nje procedure prokurimi dhe kur eshte demtuar ose rezikohet te demtohet nga nje vendim i autoritetit kontraktor, i marre ne kundershtrim me kete ligj, mund ta kundershtojte vendimin." "Ankesa i paraqitet, se pari, me shkrim, autoritetit kontraktor ne fjale brenda 7 diteve nga dita e neserme e punes kur ankimuesi ishte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni per shkeljen e pretenduar, sipas ketij ligji." "Autoriteti kontraktor shqyrton ankesen dhe merr nje vendim te arsyetuar brenda 7 diteve pas marries se kesaj ankese, te cilin duhet t'ia njoftoje ankuesit jo me vone se ne ditën vijuese te punes." Nga interpretimi i dispozitave ligjore te mesiperme, sqarojme se, afati i ankimit administrativ prane autoritetit kontraktor nis ditën e neserme te punes, pasi ankimuesi eshte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni per shkeljen e pretenduar, sipas ketij ligji si dhe forma e ankeses qe duhet te paraqese operatori ekonomik prane Autoritetit Kontraktor duhet te jete me shkrim.

Ne rastin konkret, operatori ekonomik ankimues ka marre dijeni lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me date 22.07.2019 nepermjet sistemit elektronik.

Nga shqyrtimi dokumentacionit bashkengjitur ankeses, provohet se ankesa eshte marre ne dorezim nga autoriteti kontraktor nepermjet zyres postare Kelcyre, ditën e marte, me date 30.07.2019.

Theksojme se njoftimi i klasifikimit eshte bere me date 22.07.2019 ndersa afati i fundit qe duhej te paraqitej ankesa me shkrim ne AK, ishte ditën e hene date 29.07.2019 ndersa ankesa me shkrim e dorezuar nga ana juaj ne AK me rruge postare, rezulton te jete me date 30.07.2019, sic rezulton dhe e provuar nga deftesa zyrtare si dhe vertetimi i Postes Kelcyre nr.--, date 30.07.2019 (Bashkengjitur do te gjeni kopje te defteses zyrtare si dhe vertetimin e Postes Kelcyre, e cila provon se ankesa eshte dorezuar ne AK me date 30.07.2019.

Ne rastin konkret, ankesa e B.O nuk duhet pranuar nga autoriteti kontraktor sepse, rezulton qe nuk eshte paraqitur brenda afateve ligjore te ankimit parashikuar nga neni 63 pika 2 e LPP-se.

Operatori ankimues megjithese ka paraqitur prane autoritetit kontraktor nje ankese te hartuar ne formen e percaktuar ne ligj, nuk ka pasur sukses ne dorezimin fizikisht te kesaj ankese, brenda 7 diteve nga dita e neserme qe eshte vene ne dijeni, sikurse percaktohet ne ligjin e sipercituar.

Ky mosdorezim sjell si rrjedhoje per operatorin ekonomik mospermbushjen e detyrimit per respektimit e afatit, duke mos plotesuar ne kete menyre njerin nga "elementet e domosdoshem te ankeses" dhe perben shkak per mosshqyrtimin e ankeses per themelin e pretendimeve, per shkak te mungeses se kushteve formale te saj.

Afatet e ankimit parashikuar nga neni 63 i LPP-se jane afate prekluzive.

Keto afate, duke qene afate prekluzive (dekadence) nuk mund te pezullohen, te nderpriten apo te rivendosen.

Praktika e konsoliduar e Vendimeve te KPP thekson se per shkak te specifikes se prokurimeve publike, respektimi i afateve (nder to dhe ai i ankimit), eshte i nje rendesie thelbesore e me ndikim te drejtperdrejte ne efikasitetin e procedures. [...].

Persa me siper Autoriteti Kontraktor ka vendosur: Mospranimin e ankeses se paraqitur nga BO "B93" sh.p.k & "Arkon Studio" sh.p.k & "Shendelli" sh.p.k & "Rafin Company" sh.p.k per shqyrtimin e themelit te ankimit.

II.5. Në datën 08.08.2019, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të BOE “B 93” sh.p.k & “Arkonstudio” sh.p.k & “Rafin Company” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k si dhe ngrihen pretendime për shoqërinë “Be-Is” sh.p.k, (me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor). Përsa i përket refuzimit të ankesës nga AK për mosrespektim të afateve të ankimit, ankimesi pretendon se:

“ [...] Ankesa është dërguar në rrugë shkresore, nëpërmjet Postës Shqiptare me datë 24.07.2019, me Kod Bar RR602268082AA. Objekti postar (shkresa) është dorëzuar dhe pranuar pranë Zyrës Postare Tiranë më datë 24.07.2019, ora 17:07. Objekti postar (shkresa) është dorëzuar dhe pranuar pranë Zyrës Postare Këlcyrë, Përmet më datë 26.07.2019, ora 14.35. Objektit postar (shkresa) i është dashur 4 ditë për ta dorëzuar në insitucion, Bashkia Këlcyrë nga Postieri i ZP Këlcyrë. Në datën 31.07.2019 në postën elektronike dërgohet e-mail nga Bashkia Këlcyrë, duke mos pranuar ankesën tonë me pretendimin se është jashtë afatit ligjor. Duke qënë se ankesa jonë është dërguar që në datën 24.07.2019 dhe në autoritetin kontraktor arrin në datën 29.07.2019 (sipas konfirmimit zyrtar nga Filiali i Postës Shqiptare Gjirokastër), shoqëria jonë ka dërguar një shkresë pranë Postës Shqiptare sh.a me Bar Kodin RR603602831AA për zbardhjen e rrethanave që shkaktuan vonesën dhe njëkohësisht dhe humbjen e afatit për ankimit në autoritetin kontraktor me të njëjtat arsye i është dërguar shkresë edhe Zyrës Postare në Gjirokastër me Bar Kodin RR609580697AA.

Me anë të shkresës nr. 414/1 Prot, datë 06.08.2019 Zyra Postare Gjirokastër i drejtohet shoqërisë “B 93” sh.p.k ku bën të mundur sqarimin për vonesën e ankesës sonë, duke pranuar që nga ana e postjeres janë kryer dy tentativa për të dorëzuar objektin postar në datën 29.07.2019 në Bashkinë Këlcyrë, por ajo është refuzuar të merret nga ky autoritet me pretendime aspak të zakonshme, duke thënë se personi, i cili ushtron funksionin në protokollin e Bashkisë, është me leje dhe se asnjë punonjës nuk ishte i autorizuar të zëvendësonte dhe të pranonte objektet postare.

Shprehim dyshimet tona se cdo veprim i bërë nga Bashkia Këlcyrë është i menduar mjaft mirë dhe se ky veprim i bërë nga ata do tu jepte atyre sigurinë për të vazhduar më tej me procedurat për këtë tender me shoqërinë e parapërcaktuar që në fazat e para të tenderimit. [...].”

II.6. Në datën 22.08.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1380/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1706 prot., datë 21.08.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson të ndalet në arsyetimin, përse i përket respektimit të kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Vlen të sqarohet se nisur nga faktet dhe dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi në depozitimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit ka gjykuar se ankimimi, prima facia ka respektuar kushtet formale dhe vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit, me qëllim marrjen e informacionit dhe dokumentacionit të duhur nga ana e autoritetit kontraktor, për verifikimin e fakteve dhe rrethanave përkatëse, të vlefshme për të vlerësuar në lidhje me respektimin e kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Konkretisht, nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të administruar për këtë procedurë prokurimi objekt shqyrtimi, për faktin se respektimi i kushteve formale dhe konkretisht në lidhje me afatet e ankimimit nga ana e operatorit ekonomik ankimues është i një rëndësie të vecantë mbi bazën e të cilës fillon dhe shqyrtimi i ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet pikërisht në këto afate, përse kohë që edhe autoriteti kontraktor nuk e ka shqyrtuar, duke e konsideruar këtë ankesë jashtë afateve.

Në lidhje me këto afate, si edhe lidhur me faktin e mosmarrjes në shqyrtim të ankesës së ankimuesit nga ana e autoritetit kontraktor, me argumentimin se nuk janë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës në autoritet, pas shqyrtimit, verifikimit e ballafaqimit të dokumentacionit të ankimuesit, me atë të paraqitur nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 27.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr.23687-05-24-2019, me objekt: “*Ndërtim i rrjetit të jashtëm të Ujësjellësit Këlcyrë*”, me fond limit 151.169.770 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 26.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Këlcyrë.

III.1.2. Në datën 26.06.2019 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.3. Në datën 22.07.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.1.4. Referuar parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues “B 93” sh.p.k, ky i fundit pretendon se në datën 24.07.2019, ka dorëzuar pranë Postës Shqiptare ankim drejtuar autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së BOE “B 93” sh.p.k & “Arkonstudio” sh.p.k & “Rafin

Company” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k, në proçdurën e prokurimit objekt ankimi, pasi kjo ankesë nuk është pranuar të protokollohet nga autoriteti kontraktor, ankimi i cili referuar aktit të trajtimit të ankesës, është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor datë 30.07.2019, nëpërmjet shërbimit postar.

III.1.5. Referuar materialeve të administruara pranë KPP, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.1630 prot., date 30.07.2019, me objekt “Kthim përgjigje” i autoritetit kontraktor, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë këtij të fundit, nuk ka pranuar ankesën e ankimesit për shkak të mosrespektimit të afateve ligjore të ankimit.

III.1.6. Në datën 08.08.2019, operatori ekonomik “B 93” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të BOE “B 93” sh.p.k & “Arkonstudio” sh.p.k & “Rafin Company” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k, në proçdurën e prokurimit objekt ankimi si dhe qëndrimin e mbajtur nga AK lidhur me afatet e ligjore të ankimit pranë këtij të fundit.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* *“Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”* *“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”.* Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimsht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se në datën 24.07.2019, operatori ekonomik ankimesi ka nisur ankesën e tij në rrugë shkresore, nëpërmjet Postës Shqiptare, me Kod Bar RR602268082AA, në adresën e autoritetit kontraktor Bashkia Këlcyrë. Sipas shkresës nr. 414/1 prot., datë 06.08.2019 të Postës Shqiptare sh.a, Filiali i Postës Gjirokastër, me objekt: *“Kthim përgjigje”*, drejtuar shoqërisë “B 93” sh.p.k, sqarohet si vijon: *“Menjëherë pas mbërritjes së ankesës suaj në lidhje me vonesën në dorëzim të objekti postar RR602298082AA me destibacion Bashkinë Këlcyrë, u krye verifikimi nga Sektori i Shërbimeve dhe rezultoi si më poshtë: Objekti postar me kod bar RR6022.....AA, është pranuar në Zyrën Postare Tirana Nr. 8 në datë 24.07.2019, ora 17:07. Ka vijuar në Qendrën Tranzite po në datë 24.07.2019. Ka mbërritur në Zyrën Postare Qendër Gjirokastër më datë 25.07.2019 dhe është vijuar për Zyrën Postare Përmet më datë 25.07.2019. Ka mbërritur në Zyrën Postare Përmet më datë 26.07.2019,*

ora 09:15 dhe është vijuar menjëherë për në Zyrën Postare Këlcyrë. Ka mbërritur në Zyrën Postare Këlcyrë më datë 26.07.2019, ora 14:35, orë në të cilën Institucioni i Bashkisë ka qënë i mbyllur dhe për këtë arsye nuk është kryer dorëzimi i objektit. Gjithashtu dhe gjatë ditëve e shtunë dhe e dielë, pavarësisht së zyra postare është në punë, institucioni i Bashkisë është pushim. Ditën e hënë datë 29.07.2019 në orën 09:45 nga ana e punonjësës së ZP Këlcyrë është kryer tentativa e parë për dorëzimin e objektit postar RR6022.....AA pranë Bashkisë Këlcyrë por ka rezultuar e pasuksesshme pasi punonjësja e protokollit mungonte (ishte me leje) dhe asnjë punonjës tjetër nuk e ka marrë në dorëzim postën. Në orën 12:00 të datës 29.07.2019 është kryer tentativa e dytë për dorëzimin e objektit po ka rezultuar përsëri e pasuksesshme. Nga ana e punonjësve të Zyrës Postare Këlcyrë më datë 29.07.2019 është mbajtur dhe procesverbali përkatës për arsyet e mosdorëzimit të objekteve postare që i përkisnin Bashkisë Këlcyrë. Ju sqarojmë se të gjitha objektet që i përkisnin Bashkisë Këlcyrë në Regjistrin e dorëzimit të datës 26.07.2019 nuk janë marrë në dorëzim nga punonjësit e Bashkisë Këlcyrë dhe kjo situatë është përsëritur nga Bashkia Këlcyrë. [...] Bashkëngjitur Regjistri i dorëzimit të objekteve postare, procesverbali i mbajtur nga punonjësit e Zyrës Postare Këlcyrë, historiku i ngjarjes së objektit postar me kod bar RR6022.....AA.”

Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar”, parashikohet se ankimi administrativ dorëzohet me shkrim pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor nis ditën e nesërme të punës nga marrja dijeni mbi vendimin e autoritetit kontraktor dhe mbaron ditën e shtatë. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues e ka ezuaruar ankimin administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.-së, pasi, sipas dokumentacionit të paraqitur në KPP, ankimuesi ka provuar se ankimi i tij ka mbërritur pranë autoritetit kontraktor, në datën 29.07.2019. Sipas procesverbalit të mbajtur nga Zyra Postare Këlcyrë rezulton se ankesa e tij nuk është marrë në dorëzim nga AK pasi punonjësja e protokollit ishte me leje dhe asnjë punonjës tjetër nuk ishte i autorizuar për marrjen në dorëzim të postës. Në rastin konkret, afati maksimal i paraqitjes së ankimit pranë autoritetit kontraktor nga ana e operatorit ekonomik ankimues është datë 29.07.2019.

III.1.9 Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 9 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

III.1.10. Duke vlerësuar elementët e ligjshmërisë së veprimeve të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori ekonomik ankimues e ka ezauruar ankimin administrativ pranë autoritetit kontraktor në datë 29.07.2019, brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së. Autoriteti kontraktor është përgjegjës për mosmarrjen në dorëzim të ankesës në datën 29.07.2019, sipas informacionit dhe sqarimeve të dhëna nga Filiali i Postës Gjirokastër dhe dokumentacionit bashkëngjitur këtij informacioni.

III.1.11. Në nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës; b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj; c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës; ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.”

III.1.12. Në nenin 30 “Kufijtë e shqyrtimit të ankesës” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” thuhet: “Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”

Sipas nenit 31 pika 1 gërma “b” të VKM nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: Ndalimin e autoritetit kontraktor të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor”, ndërsa në pikën 2, gërma “c” thuhet se: “Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë: Të konstatojë shkeljen ligjore konkrete dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor mbi korrigjimin e tyre, si dhe për vazhdimin e procedurës së prokurimit [...]”.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se mungesa e punonjësit të institucionit, përgjegjës për marrjen e postës dhe dokumentacionit të dorëzuar prej saj, nuk përbën shkak për mospranimin e ankesës së paraqitur nga ana e ankimuesit përse kohë që cdo institucion gjatë orarit zyrtar të punës duhet të jetë në shërbim dhe funksion të plotë, pavarësisht mungesës për arsye të ndryshme të një apo disa punonjësve të tij. Kjo arsye (mungesa e punonjësve në punë) nuk është shkak për mosmarrjen në dorëzim të postës, dokumentave, shkresave apo formularëve të ankesave për procedura të ndryshme prokurimi, cka rrjedhimisht do të thotë se asnjë institucion publik apo organ i pushtetit vendor nuk mund të ndërpresë veprimtarinë e tij për shkak të mungesës së personelit.

Përsa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankimuesi ka respektuar afatet e ankimit në AK dhe KPP, sic parashikohet në nenin 63 të LPP-së si më sipër cituar.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të BOE “B 93” sh.p.k & “Arkonstudio” sh.p.k & “Rafin Company” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k sipas së cilës: “operatori B 93 shpk ka paraqitur edhe kontraten “Ndertim ujesjellesi te fshatit Corrush Anberg “ kontrate baze +shtese kontrate .

Kontrata baze është realizuar ne vleren 75 925 925 leke pa tvsh dhe shtese kontrata ne vleren 14 262 398 leke pa tvsh. Krahas kontratave, operatori ka paraqitur edhe dokumentacionin bashkelidhur si formular vleresimi e faturat tatimore. Nga ky dokumentacion rezulton se, punimet e kontrates baze jane realizuar jashte afatit ligjor tre vjecar te vlefshme per te deshmuar realizmin e kontratave te ngjashme. Kjo sepse, sic deshmohet ne formularin e vleresimit kontrata baze ka perfunduar me daten 11.04.2016 nderkohe qe dt e hapjes ofertave eshte data 26.06.2019.

Po keshtu edhe nga faturat tatimore te kontrates baze te paraqitura rezultojne se jane jashte afatit tre vjecar te percaktuar ne rregullat e prokurimit. Nga shqyrtimi i faturave të paraqitura rezulton se fatura me e fundit e me afer dt. hapjes ofertave eshte data 01.05.2016 .

Sa më sipër, KVO gjykon se, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit, kontrata bazë ujesjellesit paraqitur nga B 93 shpk konsiderohet jashtë afatit 3 vjeçar të parashikuar nga neni 26 pika 6 e VKM 914/2014, duke mos përmbushur kriterin e kualifikimit në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë.

Ne perlllogaritjen e ketij afati trevjecar, KVO i referohet praktikës se vendimarrjeve te KPP sic është rasti i K.P.P. 521/2016, K.P.P. 874/2016 etj.

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur gjithashtu edhe kontratat me objekt “Rikonstruksioni i Rrugës Pisheporo Bregdet, Njësia Administrative Levan”, nënshkruar me AK Bashkia Fier datë 10.11.2017, kontratën me objekt “Rruga Dejë Qendër” nënshkruar me AK Bashkia Vau Dejës datë 13.05.2017. Referuar kontratave të paraqitura të sipërcituara nga B93 shpk nuk janë te natyres se ngjashme me kontraten objekt prokurimi. Nga shqyrtimi i kontratave të paraqitura rezulton se janë per ndertim apo rikonstruksion rruge ndërsa ndërsa kontrata objekt prokurimi eshte ndertim rrjet ujesjellesi.

Në këto kushte operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë se disponon kapacitetet teknike, përvojën e duhur në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar kontratën objekt prokurimi për arsye se vlere e kontratës së vetme te vlefshme (shtesë kontrate “Ndertim ujesjellesi te fshatit Corrush Anberg”) nuk arrin vlerën e kërkuar as në gërmën a) të pikës 2.3.1 a dhe pikën 2.3.1 b) të DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Operatorët ekonomikë “B 93” sh.p.k & “Arkonstudio” sh.p.k & “Rafin Company” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit lidhur para një noteri, me Nr.3153 Rep, Nr.1395 Kol datë 25.06.2019. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar për realizimin e objektit “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të Ujësjetllësit Këlcyrë”.

Në kontratën e mësipërme të bashkëpunimit, në nenin 3 “Ndarja e punimeve” parashikohet si vijon:

Llojet e punimeve që duhet të kryejë secila palë për sipërmarrjen e përbashkët përcaktohet Aneksin Nr.1, bashkëlidhur kësaj kontrate bashkëpunimi.

<i>“B-93” sh.p.k</i>	<i>do të kryejë</i>	<i>54,03%</i>
<i>“Arkonstudio” sh.p.k</i>	<i>do të kryejë</i>	<i>4.81%</i>
<i>“Rafin Company” sh.p.k</i>	<i>do të kryejë</i>	<i>13.65 %</i>
<i>“Shendelli” sh.p.k</i>	<i>do të kryejë</i>	<i>27.51%</i>

Sipas kësaj kontrate, shoqëria “B-93” sh.p.k merr përsipër të kryejë punimet hidraulike për “A Punime për linjën e jashtme” në zërat I.“Punime për kaptazhin kur burimi del në një pikë (burimi Gerdas); II “Punime për kaptazhin kur burimi është i shpërndarë (burimi Fratar); III “Punime për kaptazhin kur burimi është i shpërndarë (burimi Lagja Gur); IV “Depo grumbulluese 20m3+pusetë komandimi; V “Punime për linjën e jashtme”. Në B “Punime për stacionin e pompave dhe linjën e dërgimit” ka marrë përsipër punimet për intersektimet në rrugë të asfaltuara. Gjithashtu në D. Instalimet elektromekanike në stacionin e pompave Këlcyrë, ka marrë përsipër kryerjen e instalimeve mekanike DN125/PN25 në dalje të pompës vertikale dhe F/V e sistemit të ndricimit dhe prizave. F/V e sistemit të ndricimit dhe prizave do të realizohet nga kjo shoqëri edhe për E.Instalimet elektrike të depos së ujit Këlcyrë.

III.2.2. Në shtojcën 12, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 1, gërma “e” të dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, është parashikuar shprehimisht:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme e realizuar ne një kontrate te vetme me vlerë sa 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit (perllogaritur nga data e zhvillimit te tenderit) ose*
- b. punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e kontratave te punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit (perllogaritur nga data e zhvillimit te tenderit) është në një vlerë sa dyfishi i e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

2.3/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1. Formularin e vleresimit*
- 2. Kontratën/Kontratrat*
- 3. Situacionin përfundimtar;*
- 4. Aktin e kolaudimit;*
- 5. Çertifikaten/certifikatat e marrjes ne dorezim.*
- 6. Faturat tatimore perkatese per cdo situacion*

2.2/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1. Formularin e vleresimit*
- 2. Kontrate;*
- 3. Lejen e ndertimit*
- 4. Situacionin përfundimtar;*

5. Akt kolaudimi objekti;
6. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
7. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

III.2.3. Shtojca 9 e dokumentave të tenderit, parashikon si më poshtë:

[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULAR VLERËSIMI

(Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Autoriteti kontraktor/Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
VËRTETOJ SE:	
Autoriteti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/	
Bashkimit të operatorëve NIPDET/	
Nënkontraktoret NIPDET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit te O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar	
Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur
	E papërmbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Kontraktor	

III.2.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së paraqitur nga BOE “B 93” sh.p.k & “Arkonstudio” sh.p.k & “Rafin Company” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k për këtë procedurë prokurimi në SPE, rezulton se në përmbushje të kërkesave të sipërcituara, nga shoqëria “B-93” sh.p.k është paraqitur dokumentacioni:

1. Formular vlerësimi sipas shtojcës 9 të dokumentave të tenderit për objektin “*Mirembajtje ndertese dhe ambienti rrethues të Universitetit të Tiranës*”, me fond limit 31.025.889 lekë pa tvsh, lëshuar nga Universiteti i Tiranës; Kontratë datë 24.10.2018, lidhur midis Universitetit të Tiranës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Rafin Company” sh.p.k & “B-93” sh.p.k me vlerë kontrate 31.025.889 lekë pa tvsh me objekt "*Mirembajtje ndertese dhe ambienti rrethues të Universitetit të Tiranës*"; Situacione; Procesverbal kolaudimi; Çertifikate e marrjes ne dorezim te objektit; Fatura tatimore, Vërtetim realizimi.
2. Formular vlerësimi sipas shtojcës 9 të dokumentave të tenderit për objektin “*Sistemim asfaltim i rrugës Treblove-Peshkepi*”, me fond limit 41.291.760 lekë me tvsh për kontratën bazë dhe 7.760.167 lekë me tvsh për kontratën shtesë, lëshuar nga Bashkia Selenicë; Kontratë datë 19.06.2017, lidhur midis Bashkisë Selenicë dhe shoqërisë “B-93” sh.p.k me vlerë kontrate 41.291.760 lekë me tvsh me objekt "*Sistemim asfaltim i rrugës Treblove-Peshkepi*"; Kontratë shtesë datë 22.09.2017; Situacione; Procesverbal kolaudimi; Çertifikate e marrjes ne dorezim te objektit; Fatura tatimore.
3. Formular vlerësimi sipas shtojcës 9 të dokumentave të tenderit për objektin “*Rikonstruksion i rrugës Pisheporo - Bregdet*”, me vlerë të realizuar 92.588.220 lekë me tvsh, lëshuar nga Fier; Kontratë datë 26.09.2017, lidhur midis Bashkisë Fier dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “B-93” sh.p.k & “Ndregjoni” sh.p.k me vlerë kontrate 92.588.220 lekë me tvsh me objekt “*Rikonstruksion i rrugës Pisheporo - Bregdet*”; Situacione; Procesverbal kolaudimi; Aktin e marrjes ne dorezim te objektit; Fatura tatimore.
4. Formular vlerësimi sipas shtojcës 9 të dokumentave të tenderit për objektin “*Rruga Deje-Qender*”, me fond limit 50.308.496 lekë me tvsh, lëshuar nga Bashkia Vau i Dejës; Kontratë datë 27.03.2017, lidhur midis Bashkisë Vau i Dejës dhe shoqërisë “B-93” sh.p.k me vlerë kontrate 50.308.496 lekë me tvsh me objekt "*Rruga Deje-Qender*"; Situacione; Procesverbal kolaudimi; Çertifikate e marrjes ne dorezim te objektit; Fatura tatimore.
5. Formular vlerësimi sipas shtojcës 9 të dokumentave të tenderit për objektin “*Ndërtim i rrjetit të Ujësjellësit të Fshatit Corrush-Anbreg*”, me vlerë sipas kontratës bazë 91.111.111 lekë me tvsh për kontratën bazë dhe 17.114.878 lekë me tvsh për kontratën shtesë, lëshuar nga Sh.A Ujësjellës Kanalizime Mallakastër, sipas të cilës 100% të punimeve janë realizuar nga shoqëria « B-93 » sh.p.k; Kontratë datë 04.09.2015, lidhur midis autoritetit kontraktor Sh.A Ujësjellës Kanalizime Mallakastër dhe BOE “B-93” & “Be-Is” sh.p.k sh.p.k me vlerë kontrate 91.111.111 lekë me tvsh me objekt "*Ndërtim i rrjetit të Ujësjellësit të Fshatit Corrush-Anbreg*"; Kontratë shtesë datë 09.12.2016; Situacione; Procesverbal kolaudimi; Çertifikate e marrjes ne dorezim te objektit; Fatura tatimore.

III.2.5. Sipas ankimesit pretendohet se: “Puna e ngjashme e paraqitur nga Shoqeria "B-93" sh.p.k është konform cdo legjislacioni dhe kriteresh të percaktuar në ligjin për Prokurimet publike. Duket mjaft qarte që KVO-ja në deshperim të thelle ka gjetur "arsyet" edhe pse s'mund të quhen të tilla që të na skualifikoje. Po ju rikujtojmë që të jeni me të vemendeshme duke vlerësuar cdo dokument të paraqitur nga një OE, konkretisht në rastin tone në faqen 43 të dosjes me emertimi "Puna e ngjashme Ujesjelles Corrush Baze+Shtese OK" është Akti i kolaudimit të objektit. Ky akt është hartuar/mbajtur në dt 15.02.2017, date kjo e cila do të fillojë dhe numerin për afatin 3 vjeçar, afat ky i cili nuk është ezauruar dhe që sjell legjitimin e paraqitjes së kesaj pune të ngjashme nga Shoqeria "B-93" sh.p.k, pasi kontrata shtese trajtohet pjesë për pjesë e kontrates baze theksojmë teknikisht që një veper nuk mund të vihet në shfrytëzim nëse ajo nuk perfundon si një e tere dhe Autoriteti kontraktor e ka kolauduar objektin në kete date. Gjithashtu nëse do të ishit me të vemendeshem do të kishit konstatuar se në situacionin e kontrates shtese ka zera të trashëguara nga kontrata baze. Si është e mundur që KVO-ja mund të bëjë skualifikime për arsye që nuk janë të parashikuara në Dokumentat e tenderit dhe të shkele hapur nenin 55 pika 2 të ligjit për prokurimet publike "ndryshuar? Pra arsyeja për mbarimin e afatit 3 vjeçar të kontrates hidhet poshtë me një logjike të thjeshtë dhe duke qene pak me shume të vemendeshem.”

III.2.6. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.2.7. Në nenin 26, pika 6, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “6. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

a) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura

tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.”.

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi, në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit si dhe rregullat e prokurimit publik.

III.2.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shoqërisë “B - 93” sh.p.k, të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në plotësim të kërkesës së autoritetit kontraktor për eksperiencat të mëparshme të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik “B - 93” sh.p.k ka dorëzuar në SPE, Formular vlerësimi sipas shtojcës 9 të dokumentave të tenderit për objektin “*Ndërtim i rrjetit të Ujësjellësit të Fshatit Corrush-Anbreg*”, me vlerë 91.111.111 lekë me tvsh për kontratën bazë dhe 17.114.878 lekë me tvsh për kontratën shtesë, lëshuar nga Sh.A Ujësjellës Kanalizime Mallakastër, sipas të cilës 100% të punimeve janë realizuar nga shoqëria « B-93 » sh.p.k; Kontratë datë 04.09.2015, lidhur midis autoritetit kontraktor Sh.A Ujësjellës Kanalizime Mallakastër dhe BOE “B-93” & “Be-Is” sh.p.k sh.p.k me vlerë kontrate 91.111.111 lekë me tvsh me objekt “*Ndërtim i rrjetit të Ujësjellësit të Fshatit Corrush-Anbreg*”; Kontratë shtesë datë 09.12.2016; Situacione; Procesverbal kolaudimi; Çertifikate e marrjes në dorezim të objektit; Fatura tatimore. Nga verifikimi i kryer, KPP konstaton se Formulari vlerësimi i paraqitur në ofertë nga ankimesi, sipas shtojcës 9 të dokumentave të tenderit për objektin “*Ndërtim i rrjetit të Ujësjellësit të Fshatit Corrush-Anbreg*, me vlerë 91.111.111 lekë me tvsh për kontratën bazë dhe 17.114.878 lekë me tvsh për kontratën shtesë, jep informacion për datën e fillimit dhe të mbarimit të kontratës baze e kontratës shtesë, sic parashikohet në Dokumentat Standarde të Tenderit të Procedurës së Hapur Punë, e detyrueshme për tu paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këto procedura. Referuar formularit të mësipërm, data e mbarimit të kontratës bazë është data 11.04.2016. Në kriteret e veçanta të kualifikimit të hartuar nga autoriteti kontraktor, si edhe vetë parashikimeve të aktit nënligjor në zbatim të ligjit, KPP gjykon se operatorët ekonomikë, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme në kontratat për punë publike duhet të dorëzojnë kontrata të përfunduara, pra me anë të dokumentacionit duhet të dëshmojnë se kanë realizuar me sukses punime të përfunduara brenda 3 viteve të fundit.

Në respekt të nenit 26 pika 6 të aktit nënligjor në zbatim të ligjit në të cilën parashikohet se “*Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit*”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kontrata bazë me vlerë kontratë 75.925.926 lekë pa tvsh me objekt “*Ndërtim i rrjetit të Ujësjellësit të Fshatit Corrush-Anbreg*” është lidhur në datën 05.09.2015 midis Sh.A Ujësjellës Kanalizime

Mallakastër dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “B-93” sh.p.k & “Be-Is” sh.p.k dhe ka përfunduar në datën 11.04.2016, pra në një datë më të hershme se kërkesa e autoritetit kontraktor për *punë të ngjashme, të realizuar gjatë të tre viteve te fundit nga data e hapjes së ofertave*, pasi procedura e prokurimit objekt akimi është zhvilluar në datën 26.06.2019. Në këto kushte kontrata bazë e mësipërme ka përfunduar përpara afatit tre vjecar të aktivitetit të shoqërisë nga data e zhvillimit të procedurës.

Kontrata shtesë në vlerën 14.275.065 lekë pa tvsh nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor për *punë të ngjashme e realizuar ne një kontrate te vetme me vlerë sa 50% e vleres se fondit limit 151.169.770 lekë pa tvsh dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit (perlllogaritur nga data e zhvillimit te tenderit) në kushtet kur ky parashikim plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, që në rastin konkret është shoqëria “B-93” sh.p.k.*

Përsa i përket kontratave të tjera të paraqitura, nga shqyrtimi i situacioneve përfundimtare, rezulton se Kontrata datë 27.03.2017, lidhur midis Bashkisë Vau i Dejës dhe shoqërisë “B-93” sh.p.k me vlerë kontrate 50.308.496 lekë me tvsh me objekt "*Rruga Deje-Qender*", Kontrata datë 26.09.2017, lidhur midis Bashkisë Fier dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “B-93” sh.p.k & “Ndregjoni” sh.p.k me vlerë kontrate 77.156.850 lekë pa tvsh me objekt "*Rikonstruksion i rrugës Pisheporo - Bregdet*", dhe Kontrata datë 19.06.2017, lidhur midis Bashkisë Selenicë dhe shoqërisë “B-93” sh.p.k me vlerë kontrata 41.291.760 lekë me tvsh me objekt "*Sistemim asfaltim i rrugës Treblove-Peshkepi*" e Kontratë shtesë datë 22.09.2017 nuk përmbajnë zëra punimesh të ngjashme me zërat e punimeve të marra përsipër nga shoqëria “B-93” sh.p.k në procedurën e mësipërme të prokurimit, referuar kontratës së bashkëpunimit lidhur me Nr.3153 Rep, Nr.1395 Kol datë 25.06.2019 ndrëmjet operatorëve ekonomikë “B 93” sh.p.k & “Arkonstudio” sh.p.k & “Rafin Company” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k si më sipër cituar,

Kontratë datë 24.10.2018, lidhur midis Universitetit të Tiranës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Rafin Company” sh.p.k & “B-93” sh.p.k me vlerë kontrate 31.025.889 lekë pa tvsh me objekt "*Mirembajtje ndertese dhe ambienti rrethues të Universitetit të Tiranës*" nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit.

III.2.10. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “B-93” sh.p.k, në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor për eksperiencat e mëparshme të ngjashme dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të BOE “B 93” sh.p.k & “Arkonstudio” sh.p.k & “Rafin Company” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të ankimuesit e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimet e të BOE “B 93” sh.p.k & “Arkonstudio” sh.p.k & “Rafin Company” sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k për shoqërinë “Be-Is” sh.p.k Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.4.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet.

Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “B 93” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr.REF-23687-05-24-2019, me objekt: *“Ndërtim i rrjetit të jashtëm të Ujësjellësit Këlcyrë”*, me fond limit 151.169.770 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 26.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Këlcyrë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1380 Protokolli

Datë 08.08.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha